



**BASHKIA  
TIRANË**

**KESHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 75, datë 26.07.2017

**PER**

**PËR TRAJTIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROJEKTI “PËR  
SUBVENCIONIMIN E INTERESAVE TË KREDISË**

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 24, nenit 54 , nenit 55 pikat 3 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për Programet Sociale të Strehimit” (i ndryshuar); vendimit nr. 20, datë 20.02.2017 të Këshillit Bashkiak “Për Miratimin dhe zbatimin e programit social të strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë, hartuar sipas udhezuesit operacional”; Raportit Përmbledhës me nr. 27609, datë 19/07/2017, drejtuar Kryetarit të Bashkisë Tiranë me lëndë “Raport përmbledhës për programin social të strehimit “Subvencionimi i interesave të kredisë” në Bashkinë e Tiranës” me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

- 1.** Miratimin e aplikantëve të shpallur fitues nga Programi Social i Strehimit “Subvencionimi i Interesave të Kredisë”, sipas Aneksi 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.** Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
- 3.** Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

**K R Y E T A R I**

**ALDRIN DALIPI**